



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtërpcës (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Përmes pagesave direkte nga Thesari, bazuar në vendime gjyqësore, dhe urdhërave përmbartimore gjatë vitit 2024, transaksione në vlerë 199,066€, ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtërpçës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A2 Komuna nuk kishte hartuar një plan për subvencionimin, financimin dhe mbështetjen e OJQ-ve, kërkesë kjo ligjore e Rregullores MF-Nr 04/2017.
- A3 Nga testimi i pesë (5) mostrave në vlerë totale prej 3,210€, për obligimet e papaguara kemi vërejtur se pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 32 deri 62 ditë kalendarike.
- B1 Pasuritë e komunës respektivisht objekti spitalor me kosto historike prej 1,647,157€, dhe po ashtu pajisjet mjekësore me kosto blerëse në vlerë 1,939,409€, të pranuar teknikisht nga viti 2012 nga komuna, ende nuk ishin vënë në funksion.
- B2 Komisioni për inventarizim të pasurive i formuar me vendim të kryetarit të komunës, nuk kishte përgatitur raport për gjendjen e inventarizimit të pasurive.
- B3 Komuna nuk kishte arritur ta bëjë inspektimin (verifikimin) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtërpcës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Shtërpcës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtërpcës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtërpcës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtërpcës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, llogarive të arkëtushme, menaxhimin e obligimeve të papaguara, trajtimin e pasurive jo financiare, të cilat janë paraqitur më poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja dhe katër (4) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore, dhe urdhërave përmbartimore gjatë vitit 2024 transaksione në vlerë 191,066€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 115,236€, nga mallrat dhe shërbimet 9,378€, si dhe nga subvencionet 66,452€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

#### Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

#### Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Mungesa e planit për subvencionim të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ-ve).

<b>Gjetja</b>	<p>Paragrafi 1 i nenit 6 të Rregullores MF nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përcakton se Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës,</p> <p>Gjatë auditimi kemi vërejtur se komuna nuk kishte hartuar një plan për subvencionimin, financimin dhe mbështetjen e OJQ-ve, kërkesë kjo ligjore e Rregullores MF nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, mbi bazën e të cilës komuna ka financuar këto organizata.</p> <p>Mungesa e një plani vjetor për subvencionimin e OJQ-ve kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme për të hartuar një plan për të subvencionim të tyre.</p>
<b>Ndikimi</b>	Subvencionimi i OJQ-ve pa një planifikim vjetor të miratuar nga ekzekutivi ndikon negativisht në transparencën si dhe trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve.
<b>Rekomandimi A2</b>	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të hartohet dhe miratohet plani vjetor për financimin publik të subvencioneve në përputhje me kërkesat ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A3 - Vonesa në pagesën e faturave

<b>Gjetja</b>	<p>Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.</p> <p>Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të obligimeve të papaguara nga komuna në vlerë prej 8,937€, apo në përqindje prej 139%. Nga testimi i pesë (5) mostrave në vlerë totale prej 3,210€, për obligimet e papaguara kemi vërejtur se pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 34 deri 62 ditë kalendarike.</p> <p>Shkaku i mos pagesës me kohë ishte mungesa e fondeve financiare.</p>
<b>Ndikimi</b>	Vonesa në shlyerjen e detyrimeve mund të shkaktojë kosto shtesë për komunën sepse mund të përballlet me padi ku përveç vlerës së faturës, duhet të paguajë edhe shpenzime shtesë, përfshirë kamatën dhe shpenzimet gjyqësore.

**Rekomandimi A3** Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprkishtë i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja B1 - Menaxhim jo i duhur i pasurive**

**Gjetja** Referuar paragrafit 1 të nenit 2 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përkufizohet se “ të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit efektiv, efikas, ekonomik dhe me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi”.

Në vitin 2012, Komuna e Shtërpcës kishte kompletuar ndërtimin e objektit spitalor me një vlerë 1,647,157€, i njëjti ishte pranuar edhe teknikisht. Pas kësaj periudhe, objekti spitalor është furnizuar me pajisje mjekësore në vlerë totale prej 1,939,409€. Objekti spitalor edhe në vitin 2024 nuk është funksionalizuar. Për më tepër, janë kryer investime shtesë në vlerë prej 120,523€ gjatë vitit 2024 për përmirësimin dhe rivitalizimin e objektit të spitalit, me synimin që ta bëjë funksional dhe të përdorshëm për qëllimet mjekësore. Edhe pse objekti spitalor ende nuk është funksionalizuar vlera e tij në regjistrat e pasurisë është zhvlerësuar për 501,010€, poashtu edhe vlera e pajisjeve mjekësore është zhvlerësuar për 1,681,692€. Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara edhe katër ndërtesa banimi në vlerë prej 2,709,045€ të përfunduara për më shumë se tetë (8) vite më parë, të cilat ende nuk janë pranuar teknikisht. Sipas zyrtarëve përgjegjës komunal ndërtesat janë dëmtuar në masë të konsiderueshme dhe janë në gjendje jo funksionale.

Dobësitë në kontrolle kanë rezultuar me një menaxhim jo efikas të procesit të funksionalizimit të objektit spitalor i cili përpos që nuk është në funksion konformë dedikimit të tij për kujdesin ndaj komunitetit, është duke shkaktuar kosto vjetore të konsiderueshme për mirëmbajtjen e tij.

**Ndikimi** Shpenzimet e larta të ndërtimit të kapaciteteve spitalore, pajisjeve mjekësore si dhe infrastrukturës përcjellëse, përfshirë edhe kostot vjetore të cilat komuna, është duke i paguar çdo vit në mungesë të funksionalizimit dhe përdorimit efektiv të spitalit kanë ndikuar në humbje financiare për komunën si dhe vlerë të munguar për para.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bënë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## Çështja B2 - Mos inventarizimi i pasurive jo financiare

### Gjetja

Sipas Rregullores me Nr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.6 dhe 4.7, kërkon që “Komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit” si dhe komisioni është përgjegjës gjithashtu që “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”. Ky proces duhet ti paraprijë përgatitjes së PFV-ve.

Komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës me datë 27.09.2024, megjithatë komisioni nuk kishte përgaditur raport për gjendjen e inventarizimit të pasurive para hartimit të Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), për më tepër në katër (4) vitet e fundit në komunë nuk ishte bërë inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë konformë kërkesave ligjore. Vlen të ceket se menaxhmenti nuk kishte marrë asnjë masë ndaj komisionit për mos zbatimin e vendimit të kryetarit për të kryer dhe dorëzuar raportin konformë kërkesave ligjore, madje as nga menaxhmenti nuk arritëm të marrim ndonjë dëshmi se komisioni ka dhënë ndonjë arsye se pse nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë.

Menaxhmenti nuk është duke e trajtuar me kujdes çështjen e pasurive, kjo tregon mungesë të theksuar të kontrollit të brendshëm në komunë dhe si rezultat i kësaj gjendje e pasurive në komunë është në nivel të ulët të menaxhimit.

### Ndikimi

Mos përgatitja e raportit të inventarizimit brenda afatit të paraparë, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe në pasqyrat financiar vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e paligjshëm të pasurisë.

### Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve dhe monitorimin e komisionit të inventarizimit në menyrë që raporti inventarizimit të hartohet me kohë, respektivisht para hartimit të PFV-ve.

## Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## Çështja B3 - Mos verifikimi i plotë i pronave komunale

### Gjetja

Sipas Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, respektivisht paragrafi 2 i nenit 15 përcakton se; veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Komuna edhe në këtë vit nuk kishte arritur të plotësojë kërkesat e ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Në vitin 2024, komuna nga 4,145 objekte të cilat i kishte faturuar përfshirë këtu edhe 38 objekte të reja, kishte arritur të inspektoj (verifikojë) vetëm 311 objekte ose afërsisht 8% të tyre.

Mos verifikimi i pasurisë së paluajtshme/objekteve ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme në kuadër të aktiviteteve për verifikimin e pronave.

**Ndikimi**

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë dhe inkasimin e tyre.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,115,380€, pasurive jokapitale është 70,243€, si dhe e stoqeve 3,960€.

#### Çështja A4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

**Gjetja** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 14 pasuri në vlerë 2,957,532€, si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2014-2020, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

**Ndikimi** Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduar, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. +Mos regjistrimi i drejtë i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive jofinanciare të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e mbivlerësuar.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduar dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna ka raportuar llogari të arkëtueshme(LI/A) në PFV për vitin 2024 në vlerë prej 4,100,957€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje të konsiderueshme prej 1,113,480€. Kemi testuar 70 mostra substancile në vlerë prej 114,131€, si dhe 5 mostra për pajtueshmëri.

### Çështja B4 - Menaxhimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 21.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ligji i lartë shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përmbartimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Megjithatë, procedura përmbartimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përmbartimit ndaj Vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.

Në Pasqyrën Vjetor Financiar për vitin 2024, komuna ka paraqitur të arkëtueshmet (LLA) në vlerë prej 4,100,957€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë dhe parcela. Krahasuar me një vit më parë, shuma totale e borxhit në vitin 2024 për tatimin në pronë është rritur për 37%. Megjithëse komuna kishte marrë disa masa për të rritur inkasimin e borxheve, këto masa ishin të pamjaftueshme dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është në rritje.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

#### Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

#### Rekomandimi B4

Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>4,622,800</b>	<b>4,769,578</b>	<b>4,313,962</b>	<b>4,556,879</b>	<b>3,562,315</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	4,231,483	3,950,257	3,792,059	4,144,435	3,042,598
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	14,175
Të bartura nga viti i kaluar	0	428,004	287,054	194,606	353,658
Të hyrat vetanake	391,317	391,317	234,849	217,838	151,884

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 146,778€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak.

Komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final ose 4,313,962€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2024, komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ju kanë ekzekutuar rreth 419,416€ nga kategori të ndryshme ekonomike.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>4,622,800</b>	<b>4,769,578</b>	<b>4,313,962</b>	<b>4,556,879</b>	<b>3,562,315</b>
Pagat dhe mëditjet	3,314,817	3,033,591	3,033,591	2,966,979	2,253,056
Mallrat dhe shërbimet	556,733	592,850	485,919	497,886	465,007
Komunalitë	97,625	97,625	69,993	70,279	73,847
Subvencionet dhe transferet	100,000	183,720	125,222	49,940	16,585
Investimet Kapitale	553,625	861,792	599,237	971,796	753,820

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 281,226€, krahasuar me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim ishte si rrjedhojë e vendimit të Qeverisë së Kosovës.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 36,117€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.
- Buxheti final për komunalit kishte mbetur I pandryshuar nga ai fillestar, dhe ishte në vlerë prej 97,625€.
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 83,720€, kjo rritje ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 308,167€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga vitin 2023.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 391,317€, përderisa ishin realizuar 316,084€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative, etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku, gjobat e gjykatës dhe nga agjensioni i pyjeve në vlerë totale prej 74,926€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>391,317</b>	<b>391,317</b>	<b>316,084</b>	<b>343,332</b>	<b>311,589</b>
Të hyrat tatimore	297,628	297,628	228,670	267,609	223,523
Të hyrat jo tatimore	93,689	93,689	72,939	75,723	88,066
Të hyrat tjera	0	0	14,474		

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dy (2) rekomandime janë zbatuar dhe katër (4) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2 më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kërkesat për udhëtime zyrtare të plotësohen dhe të miratohen paraprakisht. Po ashtu, të gjitha shpenzimet duhet të llogariten dhe të dokumentohen në formularët e përcaktuar për të shmangur tejkalimet e shpenzimeve dhe për të garantuar transparencën dhe përputhshmërinë me rregulloren për udhëtime zyrtare.	Rekomandimi është zbatuar, komuna ka marrë masa përmirsuese pas raportit të vitit të kaluar dhe udhëtimet zyrtare janë bërë konformë rregullores.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë një marrëveshje të qartë për përdorimin e kartelës kreditore, duke respektuar rregulla dhe procedura të detajuara për përdorimin dhe monitorimin e saj gjatë udhëtimeve zyrtare. Të gjitha kërkesat për rritjen e limitit të kartelës duhet të jenë të përcaktuara dhe të aplikohet zvogëlimi i limitit pas përfundimit të udhëtimit. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të mbeten brenda limitit të lejuar dhe që çdo shpenzim mbi këtë limit të kthehet në fondet e buxhetit.	Rekomandimi është zbatuar, komuna ka siguruar marrëveshjen për përdorim të kredit kartelës dhe poashtu janë marrë masa përmirsuese pas raportit të vitit të kaluar për sa i takon shpenzimeve me kredit kartelë.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Komuna nuk ka arritur as këtë vit të bëjë verifikimin e pronave konformë kërkesave ligjore.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bëjnë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.	Komuna nuk ka arritur të funksionalizoj spitalin.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve dhe monitorimin e komisionit të inventarizimit në mënyrë që raporti inventarizimit të hartohet me kohë, respektivisht para hartimit të PVF-ve.	Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë raportin për inventarizim as këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Komuna nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të ulur llogaritë e arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit




## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>Komuna është institucion që ka të drejtë të paraqesë padi dhe të paditet para organeve kompetente, dhe në një procedurë gjyqësore asnjëherë nuk dihet nëse padia e paditësit do të pranohet apo do të refuzohet.</p> <p>Bazuar në Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin dhe Përgjegjësitë për Punën në Financat Publike, neni 40, paragrafi 40.3, Thesari është i obliguar që pas pranimi të vendimit përfundimtar apo urdhrit, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për pagesën e vendimit apo urdhrit nga mjetet buxhetore të disponueshme.</p> <p>Në rast se në kategorinë ekonomike Pagat nuk ka mjete të lira të mjaftueshme për pagesën e vendimeve gjyqësore të ekzekutuara, Thesari e proceson pagesën nga kategoritë tjera ekonomike ku ka mjete të lira. Pra, bazuar në sa u tha më lart, është e qartë se nuk ekziston mundësia e planifikimit dhe përcaktimit të kategorisë ekonomike për pagesën e shpenzimeve sipas vendimeve gjyqësore.</p>	E gjetura e auditorit qëndron, ndonëse pagesat janë ekzekutuar nga Thesari, në PFV-të e Komunës së Shtërpcës, në bazë të dëshmimeve, shpenzimet nuk janë paraqitur saktë dhe drejtë për shkak të keqklasifikimit të tyre.
Vonesa në pagesën e faturave	Të gjitha faturat e dërguara nga OE me numër dhe datë protokoli në muajin dhjetor kanë pasur urdhër për zotim, urdhër për blerje dhe raport për pranimin e mallit, megjithatë këto fatura nuk kanë mundur të procesohen nga zyrtarët përkatës financiarë për shkak të periudhës së shkurtër kohore dhe rritjes së vëllimit të punës.	E gjetura e auditorit qëndron, këtë e ka vërtetuar edhe Komuna me komentin që e ka sjellur.

Menaxhim jo i duhur i pasurive	Që kapacitetet ekzistuese të spitalit të vihen në funksion dhe të fillojë funksionaliteti i plotë i spitalit, komuna ka ndërmarrë një sërë hapash. Para se gjithash, janë investuar mjete shtesë dhe është realizuar renovimi i spitalit, me ç'rast objekti është i gatshëm për përdorim. Problemi me të cilin është përballur komuna është që KEDS nuk e ka pranuar kërkesën e komunës për lidhjen e spitalit në rrjetin elektrik. Edhe pse janë përmbushur kërkesat ekzistuese dhe shtesë të vendosura nga KEDS, ende nuk ka një përgjigje adekuate dhe nuk është përmbushur kërkesa për lidhjen në rrjetin elektrik. Kjo është njëra nga arsyet kryesore pse pajisjet mjekësore nuk janë instaluar dhe nuk janë vënë në funksion.	E gjetura e auditorit qëndron, pasi që Komuna që një kohë të gjatë vazhdimisht ka investuar në infrastrukturën e spitalit si dhe në pajisjet mjekësore, por edhe më tutje spitali nuk është funksionalizuar.
--------------------------------	--	--

<p>Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim</p>	<p>Në rekomandimin A4 janë përmendur 14 raste të mungesës së pranimi teknik për periudhën 2014-2020 në një shumë të përgjithshme prej 2,957,532 €. Në shtojcën e këtij komenti keni dëshmi që disa nga lëndët në rastet e përmendura kanë pranim teknik, dhe ato janë:  22/655/66660/31610/41505/0620, shuma 1,899.80 e, participimi me USAID,  22/655/66660/31260/41505/0620, shuma 3,572.80 e, participimi me USAID  22/655/66660/31124/41505/0620, shuma 3,441.12 E, participimi me USAID,  Gjithashtu, më poshtë janë lëndët me pranim teknik, mirëpo, pasi që këtu ishte fjala për pjesëmarrje, komuna nuk ka pranuar dokumentacion të plotë nga organet kompetente, duke përfshirë edhe pranimin teknik. Gjatë periudhës së përmendur komuna ka marrë pjesë me MZP, DRC, CDF dhe USAID, dhe atë në këto raste:  21/655/66660/49444/06220, shuma 1,412.58 e, participimi me DRC  10/211/46200/33200/12714/0610, shuma 15,060.56 e, participimi me MZP  10/211/46200/33200/12714/0610, shuma 7,611.66 e, participimi me MZP  21/655/66660/44678/0620, shuma 32,094.82 e, participimi me CDF  22/655/66660/31270/44017/0620 shuma 66,637.12 e, participimi me USAID.</p>	<p>E gjetura e auditorit qëndron, këtë e ka konfirmuar për disa raste edhe Komuna që ka pranim teknik, por këto pasuri nuk janë regjistruar në klasën e duhur të pasurive pasi që është bërë pranimi teknik i tyre.</p>
---	---	---



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtërpçës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet dhe kam një koment në lidhje me përmbajtjen e raportit që i kenë bashkangjitur kësaj letre dhe që do ta bëj
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Dalibor Jevtic

Data: 25.prill.2025, Shtërpçe.



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.